



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi me numër 12-470/1 të datës 22.01.2020, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent sepse pretendimet në denoncimin e dorëzuar nuk i referohen veprimeve të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtar gjat kryerjes së detyrave dhe zyrtare.

Lënda me numër 12 -7287/1 të datës 24.12.2021 të mbillet dhe të arkivohet.

Vendimi në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e Komisionit shtetërorë në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, -----, më datë 22.01.2020, është dorëzuar dhe regjistruar denoncimi me numrin 12 - 470/1, datë 22.01.2020., me akuza për pakënaqësi për ndryshimin e pragut për pagesat me para në dorë nga 500 në 3000 euro.

Denoncimi i dorëzuar paraqet një reagim ndaj ndryshimit të pragut të qarkullimit të parave të gatshme nga 500 në 3000 euro. Është një reagim ndaj ndryshimeve në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, të cilat u miratuan pas procedurës së shkurtuar në Kuvend më 27 dhjetor 2019, me iniciativë të disa deputetëve dhe me të cilin kufiri për paratë e gatshme rriten nga 500 në 3000 euro. Ulja e pragut të pagesës në cash ishte një nga asetet kryesore të qeverisë në luftën kundër ekonomisë gri, ndaj parashtruesi është i shqetësuar dhe dyshon se kjo zgjidhje ligjore është miratuar për përfitime personale të legalizimit të korrupsionit dhe ekonomisë gri për të bërë një shoqëri të kalbur, dhe në dëm të së ardhmes së popullit maqedonas dhe brezit të ri. Parashtruesi i denoncimit kërkon që KSHPK të ndër marr iniciativë sipas kompetencave të saj në lidhje me çështjet e lëndës.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se denoncimi i dorëzuar përmban pretendime të përgjithshme, pa të dhëna për veprime të kundërligjshme apo të palejueshme të personave zyrtar në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare dhe konstatoi se sipas pretendimeve të paraqitura në denoncim, KSHPK-ja nuk ka elemente për veprim kompetent i cili vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHETËTORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Nënkryetar
Katica Nikolovska

përgatiti: J.C
miratoi: K.N, anëtar i KSHPK-së

